

FJALA E DEPUTETES MERITA BAKIU

E ENJTE 9 MAJ 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar qytetarë,

Shqipëria sot është pa dyshim në një prej momenteve më të vështira gjatë dekadave të fundit, edhe shqiptarët në disa prej momenteve më të vështira, ndoshta të jetës së tyre, pasi u kërcënohet familja dhe e ardhmja. Këtë nuk e them unë, e thonë shifrat zyrtare. Rreth 60% e familjeve shqiptare jetojnë me vetëm 327 euro. 327 në muaj e gjithë familja. Në këtë situatë janë 6 në 10 familje në Shqipëri. Këto të dhëna kanë dalë në pah nga një vërtetim i Bankës së Shqipërisë. Shumë familje u goditën nga tërmeti, të tjera nga pandemia, thujse çdo shqiptar është prekur nga kriza e rritjes së çmimeve. Familjet më të varfra në vend përbëjnë 20% të totalit të familjeve shqiptare dhe shpenzojnë në muaj vetëm 60 mijë lekë për ushqim, nga 90 mijë lekë që i kanë të ardhurat totale. Pra, më shumë se 80% e buxhetit të familjes shkon vetëm për faturat ushqimore. Çmimet janë kryefjala. Që prej kohës kur Banka e Shqipërisë ka mbledhur të dhënat për këtë vërtetim çmimet e ushqimeve janë 20% deri në 21%, më të larta sipas Institutit të Statistikave. Sërish, për shumëkënd nga ju këto mund të duken thjesht shifra ose thjesht fjalë, por për shumicën përkthehen në vuajtje, përkthehen në sakrifica, përkthehen në tryeza më të varfra, përkthehen në lista më të gjata pranë dyqaneve të lagjeve. Për shumëkënd prej jush fajin e ka lufta, por çmimet nuk filluan të rriteshin me luftën, çmimet kanë filluar të rriten prej dy vjetësh tashmë. Kulmi i krizës thjesht i dha goditjen e madhe pjesës dërmuese të familjes.

Teksa takoj e bisedoj me qytetarët e mi në Krujë, jam e keqardhur, kur shikoj sesi i ka shtuar rritja e çmimeve hallet e tyre. Halle, të cilat tani janë të shkuara e zeza mbi të bardhë në fletoret e blerjeve me listë në dyqanet e qytetit. Qytetarët nuk kanë mundësi të paguajnë dhe detyrohen të blejnë ushqime me listë dhe kjo listë shkon zinxhir. Qytetari ble me listë ushqime te biznesi i vogël, biznesi i vogël ble me listë te biznesi i madh, e kështu me radhë kriza ndihet në çdo hallkë të zinxhirit. Biznesi i vogël në Krujë është në prag të falimentit dhe mbylljes së qepenave. Kjo panoramë tronditëse e Krujës, e Shqipërisë sonë të varfër ua kalon edhe atyre të viteve të diktaturës. Tani jo vetëm mbretëron skamja, por ajo është kthyer në normalitet. Kjo situatë është burim konflikti dhe problemesh sociale për çdo familje shqiptare. Sot e kërcënuar ndihet çdo grua. Sot i kërcënuar ndihet çdo burrë dhe çdo i ri. U kërcënohet e ardhmja dhe jetesa. A ka përgjegjësi qeveria jonë? Po. Çdo qeveri mandatohet për t'u shërbyer qytetarëve, këtyre të fundit ky shërbim u nevojitet kur janë keq dhe jo kur janë mirë. Çfarë bëri kjo qeveri kur çmimet e ushqimeve morën të përpjetën? Çfarë bëri kjo qeveri, kur çmimet e karburanteve kaluan edhe imagjinatën më të largët për këdo ndër shqiptarët e thjeshtë? Asgjë ose më saktë asgjë për të rregulluar situatën.

U ngritën ato dy borde me shumë trumbetim, sa në rrjete sociale dhe sa nëpër studio televizive, dy borde, të cilat nuk kanë rregulluar asgjë. Sot vaji kushton 381 lekë litri, nafta kushton 243 lekë për litër, dy bordet mblidhen sipas terezisë së tyre, jo sipas terezisë së qytetarëve. Është cilësuar si "bordi i transparencës", por vetëm transparencë që nuk bën, thjesht është një bord që i publikon vendimet në një fletë word-i, ku nuk janë as çmimet e referencës, as ato të transportit dhe asgjë tjetër. Pra, ka zero transparencë, thjesht një çmim për secilin produkt. A duhet ta dimë ne, a duhet ta dinë të gjithë qytetarët përse po e paguajmë naftën 243 lekë për litër? A duhet ta dinë qytetarët se përse nafta në

Shqipëri është ndër më të shtrenjta në botë, jo në Europë apo në rajon, por në botë? Të paktën, deri në datën 2 maj, bazuar në shifrat e Global Petrol Prices, Shqipëria është e 12-ta në botë për çmimin më të lartë të naftës. Luksemburgu me pagë mesatare 10 herë më të lartë se Shqipëria e ka naftën më të lirë se ne. Holanda, Italia, Spanja, Franca e shumë vende të tjera ofrojnë një çmim naftë më të lirë se Shqipëria jonë e bekuar. Në secilin nga këto pak shtete që radhita pagat mesatare, të ardhurat, mirëqenia janë në nivele të pakrahasueshme me ne, por për këtë është faji i atyre që janë mandatuar, sepse duhet t'u japin drejtim gjërave. Çdo qeveri, kurdoherë e ka për detyrë të amortizojë kostot për qytetarët dhe për bizneset në rast krize. Çdo qeveri, kudo qoftë, duhet të jetë e përgatitur për çdo skenar. Qeveria jonë jo vetëm që u gjend e papërgatitur, por vazhdon të jetë e tillë. Faleminderit!